

LIGJ
Nr.7676, datë 2.3.1993

PËR TATIMIN MBI QARKULLIMIN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Personat fizikë dhe juridikë, vendas apo të huaj të cilët prodhojnë ose importojnë mallra si dhe kryejnë shërbime apo ndërtime në territorin e Republikës së Shqipërisë, paguajnë tatim mbi qarkullimin.

Neni 2

Tatimi mbi qarkullimin, zbatohet për shitjet e realizuara nga prodhuesit e mallrave, për shërbimet e ndërtimet e kryera nga subjektet e ndryshme, si dhe për mallrat e importuara.

Neni 3

Tatimi mbi qarkullimin e mallrave nuk zbatohet për:

- Materialet, pajisjet e makineritë që vijnë nga importi për ndërtime, montime dhe rikonstrukcione objektesh dhe që do të destinohen për t'i shërbyer procesit të prodhimit, ndërtimit e shërbimit.

Personat fizikë e juridikë vendas apo të huaj pavarësisht se importimin e tyre e realizojnë drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet personave të tjerë juridikë do të vërtetojnë në doganë me dokumente përkatëse përdorimin e tyre dhe do të japin garanci që këto mallra nuk do të shiten apo transferohen në origjinë.

- Lëndët e para dhe materialet që do të importohen për t'u përpunuar në procesin e prodhimit nga vetë subjekti prodhues.

- Traktorët, makineritë dhe veglat bujqësore që vijnë nga importi dhe që prodhohen në vend.

- Mallrat që eksportohen me përjashtim të energjisë elektrike dhe të disa mineraleve që përcaktohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Ministrinë e Industrisë, të Burimeve Minerare dhe Energjitike.

- Të gjitha llojet e botimeve të letërsisë, revistave, kasetave dhe videokasetave të regjistruara të repertorit kombëtar.

- Mallrat që përjashtohen nga taksat doganore sipas nenit 3 të ligjit nr.7675, datë 2.3.1993 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7609, datë 22.9.1992 "Për tarifat doganore".

Këshilli i Ministrave ka autoritetin të bëjë përjashtime e lehtësira të përkohshme nga tatimi mbi qarkullimin për ndërmarrjet shtetërore, kur ekonomikisht kjo është e domosdoshme.

Neni 4

Tatimi mbi qarkullimin llogaritet në masën:

- 20 për qind për bashkësitë ekonomike dhe për degët e tjera, ku tatohen produktet që shiten jashtë tyre, dhe 15 për qind për të gjitha subjektet e tjera.

- Subjektet e shtojnë tatimin në faturë dhe mbledhin tatimin nga blerësi për llogari të shtetit.

- Për bashkësitë ekonomike tatimi mbi qarkullimin do të zbatohet për mallrat që shiten jashtë saj. Për degët ekonomike të tekstil konfeksioneve, të lëkurë-këpucës, të drurit e të mekanikës tatimi

mbi qarkullimin do të zbatohet për produktin përfundimtar që shitet jashtë tyre.

Neni 5

Tatimi mbi qarkullimin paguhet vetëm një herë. Çdo shitje e mëtejshme nuk i nënshtrohet tatimit mbi qarkullimin.

Për mallrat që prodhohen brenda vendit apo për shërbimet, tatimi mbi qarkullimin llogaritet në bazë të vlerës të çdo sasive malli të shitur apo shërbimi të kryer dhe detyrimi për pagimin e tatimit mbi qarkullimin fillon nga koha kur subjekti nis faturën në adresë të blerësit.

Për mallrat që importohen, tatimi mbi qarkullimin llogaritet në bazë të vlerës doganore dhe paguhet me pagimin e taksës doganore.

Për ndërtimet, tatimi mbi qarkullimin llogaritet mbi diferencën në vlerë midis kostos së objektit dhe vlerës së materialeve.

Neni 6

Organet doganore detyrohen të bëjnë llogaritjen dhe arkëtimin e tatimit mbi qarkullimin e mallrave që importohen, të cilin e derdhin brenda 5 ditëve në buxhetin e shtetit për llogari të organeve tatimore.

Neni 7

Tatimi mbi qarkullimin e mallrave derdhet në buxhetin e shtetit. Shitësi i mallrave apo subjekti që ka kryer shërbimin ose ndërtimin detyrohet të llogaritë dhe të derdhë në buxhetin e shtetit tatimin mbi qarkullimin e mallrave brenda 5 ditëve.

Neni 8

Të gjitha subjektet dhe organet doganore detyrohen të mbajnë llogari të veçantë për tatimin mbi qarkullimin e mallrave, si dhe të plotësojnë e të dërgojnë në organet tatimore deklaratën periodike mujore mbi tatimin e realizuar e të derdhur, brenda datës 10 të muajit pasardhës.

Neni 9

Quhen shkelje të këtij ligji:

- Fshehja e tatimit mbi qarkullimin e mallrave.
- Fallsifikimi i të dhënave dhe i dokumenteve bazë për llogaritjen e tatimit.
- Mbajta e gabuar e llogarive kontabël të tatimit mbi qarkullimin e mallrave.
- Derdhja me vonesë e tatimit në buxhetin e shtetit.
- Paraqitja me vonesë pa shkaqe të arsyeshme e deklaratës periodike mujore mbi tatimin e realizuar dhe të derdhur.
- Mosparaqitja në afatin e caktuar e deklaratës vjetore parashikuese mbi qarkullimin e mallrave që do të kryhet.

Neni 10

Shkeljet e parashikuara në nenin 10, pavarësisht nga ndjekja penale, dënohen edhe me këto masa administrative.

- Fshehja dhe fallsifikimi i tatimit mbi qarkullimin e mallrave, me gjobë sa 5-fishi i shumës së tatimit të fshehur ose fallsifikuar, si dhe me marrjen e tatimit të fshehur në masën 100 për qind.

- Mbajta e gabuar e llogarive kontabël, me gjoba nga 10.000 lekë - 50.000 lekë, sipas masës së gabimit të bërë.

- Derdhja me vonesë në buxhetin e shtetit, me gjobë 10.000 lekë dhe me pagimin e kamatvonesës në masën 0.2 për qind për çdo ditë vonesë.

- Paraqitja me vonesë pa shkaqe të arsyeshme e deklaratës periodike mujore mbi tatimin e realizuar dhe të derdhur dënohet me gjobë 2000-5000 lekë.
- Mosparaqitja në afatin e caktuar e deklaratës vjetore parashikuese mbi qarkullimin e mallrave, që do të kryhet, dënohet me gjobë nga 6000 deri në 8000 lekë.

Neni 11

Tatimi mbi qarkullimin e mallrave nuk zbatohet për mallrat ndaj të cilave me ligj të veçantë zbatohet akciza si dhe për personat fizikë që i nënshtrohen ligjit "Për biznesin e vogël" me përjashtim të rasteve kur këta të fundit importojnë mallra.

Neni 12

Ligji nr.7543, datë 24.12.1991, ndryshuar me ligjin nr.7584, datë 14.7.1992 dhe ligjin nr.7639, datë 19.11.1992 "Për tatimin mbi qarkullimin e mallrave", si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

Shpallur me dekretin nr.481, datë 9.3.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.